

Informacion rreth jurisprudencës nr. 111 të Gjykatës

gusht – shtator 2008

## **Grayson dhe Barnham kundër Mbretërisë së Bashkuar - 1995/05**

Vendimi datë 23.9.2008 [Seksioni IV]

### **Neni 6**

#### **Procese penale**

#### **Neni 6-1**

#### **Procesi i rregullt ligjor**

Kalimi i pjesshëm i barrës së provës mbi të pandehurin për qëllim të llogaritjes së shumës së urdhrat të konfiskimit në çështjet e trafikut të drogës: *nuk ka shkelje*

*Faktet e çështjes:* Të dy kërkuesit ishin dënuar për veprën penale të trafikut të drogës dhe ishin dënuar me burgim. Në përputhje me Aktin e Trafikimit të Drogës të vitit 1994, në fazën e parë të procedurës së konfiskimit, i takonte Prokurorisë të përcaktonte, duke parazpeshuar gjasat, që i pandehuri kishte shpenzuar ose fituar shuma të caktuara parash gjatë gjashtë viteve para fillimit të veprës penale. Akti e autorizonte gjykatës të prezumonte se e gjithë prona e zotëruar nga një person i dënuar për një vepër penale të trafikimit të drogës brenda gjashtë viteve të fundit përfaqësonte të ardhura nga trafiku i drogës. Më pas, barra i kaloi të pandehurit për të treguar, përsëri bazuar në baraspeshimin e gjasave, se paratë kishin ardhur nga një burim legjitim. Në fazën e dytë të procesit, barra i kaloi të pandehurit për të vërtetuar se pasuritë e tij të realizueshme ishin më pak se shuma e përfitimit që ai vlerësohej se kishte marrë nga trafiku i drogës. Meqenëse kërkuesit nuk kishin vërtetuar se pasuria e tyre e realizueshme ishte më e vogël se shuma e përfitimit të vlerësuar për ta, urdhrat e konfiskimit ishin lëshuar të barabartë me atë shumë. Kërkuesit mund të vuanin burgim më të gjatë nëse nuk paguanin shumat përkatëse brenda afatit të përcaktuar. Ata e apeluan vendimin, por pa sukses.

*Ligji:* Në çështjen *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 41087/98, ECHR 2001-VII; në Shënimin Informativ nr. 32), Gjykata kishte vendosur se ndryshimi i barrës së provës në proceset e konfiskimit pas një dënimi për një vepër të trafikut të drogës ishte në përputhje me nenin 6. Në çështjet në fjalë, detyra e Gjykatës ishte të përcaktonte nëse mënyra në të cilën ishin zbatuar prezumimet ligjore në proceset e konfiskimit kishte cenuar parimet bazë për proces të rregullt ligjor në përputhje me nenin 6 § 1. Gjatë gjithë procesit gjyqësor të konfiskimit ishin mbrojtur të drejtat e mbrojtjes përmes zbatimit të garancive të integruara në sistem. Për rrjedhojë, në secilën çështje ishte kryer vlerësimi nga një gjykatë nëpërmjet një procedure gjyqësore që përfshinte një seancë gjyqësore publike, zbulimin paraprak të çështjes së Prokurorisë (për mbrojtjen) dhe mundësinë që kërkuesit të paraqisnin prova shkresore dhe me gojë. Secili kërkues ishte përfaqësuar nga një avokat i zgjedhur prej tij. Para Gjykatës, asnjë kërkues nuk ishte ankuar seriozisht për rregullsinë e fazës së parë të procesit të konfiskimit që kishte llogaritur përfitimin nga trafiku i drogës. Nuk ishte e papajtueshme, në parim apo në praktikë, me konceptin e procesit të rregullt ligjor sipas nenit 6, që barra e provës t'u ngarkohej kërkuesve, pasi ata ishin dënuar për një vepër të rëndë të trafikimit të drogës, dhe që ata të vërtetonin se burimi i parave ose

pasurive të cilën ata kishin dëshmuar se e kishin zotëruar në vitet para veprës penale ishte i ligjshëm. Duke pasur parasysh ekzistencën e masave mbrojtëse të përmendura më sipër, barra mbi ta nuk i kishte tejkaluar kufijtë e arsyeshëm.

Për më tepër, gjyqtarët kishin diskrecion për të mos zbatuar prezumimin e kundërshtuar nëse, sipas mendimit të tyre, ai do të shkaktonte një rrezik të rëndë padrejtësie. Për sa i përket fazës së dytë të procesit të konfiskimit, kërkuesit kishin zgjedhur të jepnin prova me gojë në lidhje me pasuritë e tyre të realizueshme. Ata ishin të përfaqësuar ligjërisht dhe ishin informuar, përmes vendimeve të hollësishme të gjyqtarëve, se si ishte llogaritur saktësisht shifra e përfitimit. Atyre iu dha mundësia të shpjegonin gjendjen e tyre financiare dhe të përshkruanin se çfarë kishte ndodhur me pasuritë që gjyqtari kishte marrë parasysh për përcaktimin e shifrës së përfitimit. Kërkuesi i parë, i cili ishte konstatuar se kishte shuma të mëdha parash të pashpjegueshme që kalonin nga një llogari e tij bankare në një llogari tjetër, nuk kishte arritur të jepte ndonjë shpjegim të besueshëm për këto anomali. Kërkuesi i dytë as nuk ishte përpjekur të shpjegonte se çfarë kishte ndodhur me ngarkesat e ndryshme të kanabisit që ai ishte thënë se kishte blerë. Në secilin rast, gjyqtari konstatoi se provat e kërkuesit ishin krejtësisht të pandershme dhe jo të besueshme. Nuk i takonte Gjykatës Evropiane të bënte vlerësimin e vet të provave dhe të zëvendësonte vlerësimin e gjykatave kombëtare. Gjithashtu, duke qenë se ishte vërtetuar se kërkuesit ishin përfshirë në tregti të gjerë dhe fitimprurëse droge për një periudhë prej disa vitesh, nuk ishte e paarsyeshme të pritej që ata të shpjegonin se çfarë kishte ndodhur me të gjitha paratë të cilat sipas Prokurorisë ishin në zotërim të tyre, po aq sa ishte e paarsyeshme që në fazën e parë të procesit të pritej që ata të tregonin legjitimitetin e burimit të këtyre parave. Çështje të tilla binin në fushën e njohurive të veçanta të kërkuesve dhe barra mbi ta nuk do të ishte e vështirë për t'u përmbushur nëse deklaratat e tyre lidhur me çështjet përkatëse financiare do të ishin të vërteta.

*Përfundimi:* nuk ka shkelje (me unanimitet).

Gjykata vendosi se nuk ka shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1.

Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut  
Kjo përmbledhje e Sekretarisë nuk është detyruese për  
Gjykatën

Klikoni këtu për më shumë informacion rreth [Case-Law Information Notes](#)